FERIT LAMAJ

MBRETI XHUXH

fabula

FERIT LAMAJ

Mbreti xhuxh

F a b u l a

TIRANË, 2007

Redaktore: **Jonida LAMAJ**

Piktor: **Llazar TAÇI**

Botues: **ILAR**

©: Autori & Botuesi

E - mail: feritlamaj@yahoo.com
www.geocities.com/feritlamaj
Tel: 229 990; 069 22 75 338

ISBN 978-99956-611-8-2

Mbreti xhuxh

Ja dhe xhuxhët, eh, ç'qyfyre,
Seç i thonë Mbretit të tyre
Me përulje, simpati:
"Madhëri, Madhëri!"

Duhanpirësit

Qenka shkruar mbi paketë
“Duhani dëmton shëndetin”
Gjelkokoshi si shigjetë
Qorton veten dhe gjeldetin:
- Duhet marrë shpejt vendimi:
Heqim dorë nga ...leximi!

Tërheqje

Çimi qenit i jep dush:
- Lëre macen, o qenush!
Ç'ke me bishtin, pse ia nget?
Mos u bëj i keq!

"Ham, ham!" qeni, seç ia pret:
- Ç'faj kam unë! Macja vetë
Bishtin e tërheq...

Kaçurrelat

Kjo iriqja një ditë vere
I shkoi pelës parukiere:
- M'i bëj flokët, - tha te pela, -
Rrica – rrica, kaçurrela!...

Era

Ç'i thotë dashit një kotele
Tutje, në avlli:
"Bëj çudi, por zonjës dele
I vjen era dhi!"

Avokatja

Çdo lloj halli po e pate,
Ta zgjidh dhelpra avokate.
Fare rrallë mashtron akuzën:
Veç kur çel edhe mbyll buzën...

Pendë

- Pulë, je kot! -
I tha një dhi: -
Pendë plot
E shkrim nuk di...

Zgjidhe shokun më të mirë!

Beci kecin na kish shok;
S'gjeje, jo, më çamarrok.
Qysh s'i linte dy gurë tok.

Babi dashi qorton becin:
- S'ke shok tjetër, ç'rri me kecin?
Ç'thotë proverbi, more bir:
"Zgjidhe shokun më të mirë!"

Ia pret beci: - O ba, ç'thua!
Keci pra, më zgjodhi mua...

Televizori

Teksa prehej mbi divan
Buçja pyet qen leshtorin:
- Të kam shpirt e të kam xhan,
Ta shoh pak televizorin?

Qeni bishtin lehtë lëviz:
- Ta shikosh, veç ...mos e ndiz!

Qyl

Qeni ynë tyryfyl
Seç i pi cigaret qyl.
Lyp te daci, te patoku,...
Më qyltar s'i gjendet shoku.

Daci qenit llafraketë:
- Sot e tutje s'blej paketë!
Kam vendosur,- i zbardh planin,-
Që, ti qen, ta lësh duhanin...

Freskim

Stolat në lulishte
Xixë, të shkëlqyer.
Një tabelë grishte:
“Bojë e porsalyer”

“Bojë e freskët, mjau!” –
Daci torollak.
Fët drejt stolit ngau,
Të freskohej pak...

Fodulli

Fodullëku s'paska brirë.
Që ta tjerrim llafin mirë,
Qeni bishtin bën turjelë:
- Ç'kanë me mua, më thonë "gjel"?!

Ia fut macja fët një çokë:
- Kyçe sqepin, mos çaj kokë!...

Gjuhë

Orë Gjuhe sot në klasë;
Në dërrasë gici ...dërrasë.

"Buçja buçe, një zanat:
Me dy qen flirton në shtrat..."
Ç'është buçja? – pyet pata,
Pyet pata qafëgjata.

Flet patoku llafin valë:
- Kryefjalë, kryefjalë!

Ia pret gjeli urtë e butë:
- Ç' kryefjalë?! ...Prostitutë.

Çorap

Ujk banditi shkon në treg,
Që të blejë çorap tek.

Dhe pastaj në pritë e terr
Të rrasë ...kokën menjëherë.

Fakti

Qeni buçen zë një natë
Me jaranin mu në shtrat,
Turravrap e në gjykatë:
- Dua ndarjen sot o kurrë!

Por gjyqtari burrë po burrë,
Se me buçen kish bërë paktin:
- Qysh t'ju ndaj, e pe mirë faktin?

Qeni gojën na-a si shpellë:
- Jo, s'e pashë, qe rrasur thellë...

Mesnatë

U lind biba në mesnatë.
- Më fal, mami, mami patë!
Kam bërë faj, - fët kokën tundi,-
Se të zgjova sot nga gjumi...

Veza

Majmunushi këmbëpurtekë
Shkon të blejë një vezë në treg.

- Vezë të freskët, - seç po thotë,-
Ndryshe lekët ç't'i hedh kot!

Ia pret pula: - Pu-pu, ç'naze!
Veza është valë, taze;
S'ka pak çaste që e bëra.

- Boll me thumba e gjilpëra, -
Majmunushi llafraketë:-
Thashë "të freskët", jo "të nxehtë"...

Xhep xhepisti

Xhep xhepisti, hajn me famë,
I ka gishtat si me zam.
Çfarë zami! ...Me magnet;
More, grepa të vërtetë...

Në një ishull krejt të shkretë
Xhep xhepisti vjen vërdallë:
Kë të rrjepë, hall mbi hall!

Fluturimthi, si raketë
Dorën rras te xhep' i vet.
Si usta e ujk i vjetër
Ia ngjesh paret xhepit tjetër...

Shkrim e këndim

Ky patoku flet si trim:
- Unë, o gjel, të thaj në shkrim!

Pendën shtrin e për çdo ditë
Në fletore shkarravit.

Pyet gjeli: - Ki, ki, ki!
Çfarë ke shkruar, mund ta di?

Fët patoku: - Miku im,
Si fatkeq nuk di lexim...

Verë

Një kërriç, me ç'thonë, njëherë
Desh të dehë zebrën me verë.

Pall kërriçi: - Bëj çudi!
Të dhemb koka, pse nuk pi?

Llaf i zebrës afsh i valët:
- Jo, se ...më bën keq për shalët.

Flet kërriçi flakë për flakë:
- Pse, t'i fryn, t'i bën fulltakë?

Ç'ia rras zebra kunjin fap:
- Jo, s'm'i fryn, porse m'i hap...

Birra

Te lokali si çdo ditë
Dhelpra birrë porosit.
Seç i shkrepi këtë herë:
- Merre birrën, sillma verë!

Sakaq verën kthen me fund.
Bën t'ia mbathë, jo, jo, s'mund.
Kamerierët kyçin derën:
- S'ke ku shkon, paguaj verën!

I merr dhelpra me të mirë:
- E këmbeva me një birrë!

Kamerierët në kor thirrën:
- Atëherë paguaj birrën!

Qahet dhelpra: - Zot na ruaj!
Kur s'e piva, ç'ta paguaj...

Banja publike

Pylli festë paska sot,
Kafshët mbledhur si kurrëmot.
Mbret Luani po bën ritin,
Mban fjalim e pret shiritin:
- Pylli ynë, pyll modern,
S'do njohë bajga në terren...
Ta gëzoni, miq e mike,
Këtë banjë, banjë publike!

Pas një jave sherr o sherr;
Lepurushi dyllë e vrer
Mbret Luanit i thotë prerë:
- O vër rregull, Madhëri,
Ose prishe që tani!
Ky Ariu putërmadh
Mirë që hyn fishek pa radhë,
Por si leckë më përlan;
Më përdor, more aman,
Për hiçgjë e pa pikë frike
Si një letër higjienike...

Në urban

Në urban shoferi flet;
Llaf i prerë, llaf-tërmet:
- Qytetarë, qytetare,
Nuk lejohet, jo, cigare!

Por një xhajë mjaft serbes
Eshkën qet e llullën ndez.

Tym shoferi: - More mik,
S'paske veshë, pse s'e fik?

Ia pret xhaja si qyqar:
- Unë, or ti, jam katundar...

Tetanozi

Dy hardhuca morën krosin,
“Fët” të bëjnë tetanozin,
Se u mposhtën në duel
Nga iriqi qimetel...

Plakushi

Një majmun, plakush i ngratë,
I thotë mjekut si me zor:
- Urinoj çdo ditë më shtatë;
Jam në hall, zoti doktor!
Më vjen turp, sa ç'të të them...

Ia pret mjeku: - S'ka problem!

- Halli është, - plaku flet, -
Zgjohem fiks në orën dhjetë...

Qimekuqi

Leopardi paska hak,
I shkon mjekut tym e flakë:
- Ç'na del pjella qimekuq!
Mos ka zonja ndonjë huq...?

Në çast mjekut diç i feks:
- Bëni seks a s'bëni seks?

Leopardi bishtin ter:
- Gjithë vitin veç dy herë.

Ia pret mjeku fluturim:
- Çështje ndryshku, miku im!...

Syzet

Flet arushi gojëplot:
- Gjyshi syzet i do shumë.
Nuk i heq as dhe në gjumë,
Ndryshe ëndrrat s'i sheh dot...

Panair

Mbledh këlyshët zonja mace.
Jo, s'kam parë më kurnace.
- Rrini urtë, rrini mirë,
Që t'ju çoj në panair;
Të shikoni, moj kotele,
Çokollata, karamele...

Skara

Daci piqte mu në skarë
Qofte, shishqebap.
Varg salsiçet një zagar:
- Dac, m'i piq me vrap!

Daci sytë bën dollap:
- Nuk e sheh, që ka tejngopje!
Është skarë, jo fotokopje...

Shkrepëse

Gici merr një fije...
Sa i paska hije!
E fërkon serbes,
Porse nuk i ndez.
Gjithë inat e flak.

Ja, sërish pas pak
Kap një fije tjetër.
Si usta i vjetër
E shket te fosfori...
Fija flakë mori.

Gici nur e dritë
Nis e dërdëllit
Pa një çikë takt:
“Kjo qenka e saktë!”
Dhe si për çudi
E rras në kuti...

Burg

Dhelprës mbrëmë nuk i eci,
E mbërthyen te koteci.

Fët gjykata merr vendim:
- Dhjetë ditë burg, ta kesh mësim,
Vëth në vesh për tjetër herë.

Hidhet dhelpra shend e verë:
- Dhjetë ditë, oh, sa mirë!
Sa për netët jam e lirë...

Futboll

Gici llafet fjollë - fjollë:
- Ç'u kënaqa në futboll!

Lepurushit s'i rri goja:
- Po ti s'di nga bie loja!

Ç'i tha gici, rondokopi:
- Lepurush, unë isha ...topi.

Not

Një majmun lahej në det,
Kur papritur zë thërret
Me “oi” e papushim:
- Ej, u mbyta, ndihmë, ndihmë!
Më shpëtoni, se s’di not...

Mu në breg prehej një derr.
Noçkën zgjat e llap në erë:
- Majmunush, ç’ia fut më kot!
Edhe unë not nuk di,
Por s’gërthas e s’qaj si ti...

Defekt

Shkon avioni përmbi re;
Si pilot është zoti dre.
Jep alarmin fort i gjori:
- Ka defekt të rëndë motori!

Udhëtarët zemërngrirë
Mprehin veshë, tundin brirë...

Nis paniku, po ç'panik!
Llap derrkuci gjithë frikë:
- Ky ankth sot na daltë për hajër,
Ndryshe ngecëm lart, në ajër...

Kopje

Pall gjirafa gjithë gëzim:
- Mora dhjetë në provim!

Majmunesha bën çudi:
- More dhjetë, qysh e si?!
Se kjo dihet, ti në tru
Ke veç ashkla, ke veç dru!

Qetë – qetë kjo gjirafa:
- Tru nuk kam, por më rroftë qafa!...

Origjina

Një derrkuc, derrkuc nga Hasi
Gjel sauksin një ditë hasi
Mu në qendër, në Tiranë:
- Po ne jemi nga një anë,
Na kap Shqipëri e Mesme;
Eja pra, ta bëjmë një resme!*
Le ta kemi si kujtim...

Iu turr gjeli: - Miku im,
Ç'ia fut kot e llap qesim!
Hasi, gico, mesa di,
I ka rrënjët në Veri.

Noçk' e gicit shkreptiu:
- Qenke fare, çfarë Veriu!
Flas me fakte, flas me prova,
Në Veri shtrihet Kosova...

* foto

Noterja

Kjo kunadhja është notere.
Di, moj, di kujt t'i bëjë ndere.
Kush i fal plus ndonjë pulë,
Fët ia nxin shkresën me vulë.
Shkresa false mund të jetë,
Por... është pula e vërtetë.

Kjo kunadhja, motër, xhane,
Qenka dhelpër, pehlivane.
I zbraz firmat në deftere:
Është notare, jo notere...

Xhepat

Pantallonat kanë një xhep
Aq të vockël mu në cep,
Që shet mend porsa zë darka:
- Plotpërplot jam me qindarka!

Xhep' i brendshëm në xhaketë
I përplas një të vërtetë:
- Ti qindarka, unë kuletë...

Toka

Toka Marsit i shet mendje:
- Pa dëgjomë me vëmendje,
Unë jam Toka, unë jam Toka...

Thirr e thirr e nuk pushoka.

- Mjaft, moj ti, se na dhemb koka!
Ç' "tokë", llap me zhurmë e bujë,
Treçerekun e ke ujë...

Taksia

Lypi dosa një taksi,
Ta çojë në Shijak.
Porse dera për çudi
S'po e nxë aspak.

Tek sheh skenën, leh një bub
"Ham-ham!" pa vonesë:
- O shofer, pse s'bën dy rrugë?
Merre pjesë – pjesë...

Urim

I tha bletës
Një ditë grera:
- Më uro, se
...Më vdiq vjehrra (!)

Mbytje

Seç llap macja llafeshumë:
- Mjau! S'mbytem kurrë në lumë,
Në liqen, as dhe në det;
Jam notare e vërtetë!

Mjerisht macja desh u mbyt
Me pështymë mu në fyt...

Librezë uji

Sa çudira ka ky treg:
Shishe e ujit treqind lekë!

Një majmun librezën tund:
- S'është parë askurrkund!-
Kokën fët po zë të kruajë:-
Në shtëpi dyqind paguaj
Jo për shishe, por për muaj...

Shtatzënë

Buçja bie prapë me barrë.
Në spital bën si e marrë:
“Çne kjo gjëmë, ky tërmet,
Prapë dy kone, vajmedet!”
I thotë mjekut: “O iriq,
Një këlysh, pra, shpejt ma hiq,
Sa s’është dhënë lajmërimi,
Se më duket, s’është imi!...”

Çadrat

Shiten çadra në pazar:
Dhjetë, pesë, dy dollarë.

Flet ariu gjynahqar:
- Zonja dhelpër, më bëj be,
Më të lirë vallë s'ke?

Dhelpra bishtin hedh litar:
- Kjo këtu vlen një dollar.

Fët ariu si fakir:
- Më të lirë, më të lirë?!

Dhelpra qesh e tall ariun:
- Më të lirë kemi ...shiun.

Kopsat

Ç'po bën cjapi me gjilpërë?
Fijeperin shkon në vërë.

Nxehet kali: - Ç'kokëmish!
Qep vetë kopsa në këmishë,
Kur ke dhinë sa një mal?!

Ia pret cjapi: - Eh, or kalë,
Flasim shkoqur, kjo këmishë
S'është imja, por e dhisë...

Kokë

Llap gomari në kuvend:
- E kam kokën plot me mend!
Plot me mend e plot me tru...

Ia pret dhelpra: - Jo kështu!
Koka jote, flas pa hatër,
Ka një vlerë, se vlen për çadër.
Kurdoherë që ia kris shiu,
Të mbron qafën, gomarziu...

Në Pranverë

Eh, ç'u kthye kohë e lashtë:
Çupat gjoksin, barkun jashtë...

Pyet mamin teta Klara:
- Cila lule çel e para?

Ia pret mami shend e verë:
- Manushaqja plot me erë!

Teta Klara kokën tund:
- Çel e para në katund. -
Më tej fjalët thumb si driza: -
Në qytet na çel kërthiza...

Ndalim kalimi!

Një derrkuc polic rrugor
Tek sheh qenin mbi motor,
E ndalon te kryqëzimi,
Në një udhë "Ndalim kalimi!"

Gic polici bëhet bishë:
- Qenke birbo, kokëmish...
S'sheh tabelën sa një mal?

Ia pret qeni: - Gic, më fal!
Jam polic, polic special –
(fët i qet një dokument) –
Kam një rast tepër urgjent:
Po ndjek ujkun kriminel,
Që kaloi vrull rrufeje
Dy sekonda para meje...

Provimi

Buzagaz kangur këlyshi
Hidhet fushës me kërcim.
- Çamarrok,- e pyet gjyshi,-
Hë, si dole në provim?

Fët këlyshi gojën shqep:
- Ku ta di, e kam në xhep!...

Dushi

Ngeli zonja pa u larë,
Iu prish dushi, ka të çarë.

Vjen urgjent hidrauliku,
Tak e tak e ngjiti miku.

I thotë zonjës afsh e prush:
- Hë pra, zhvishu, bëj një dush!
Bëj një dush, sa s'është vonë,
Që të shoh nëse pikon…

Varfëri

- Hudhrën, - tha qenushi,
Dhe syçkat përpushi –
E kam shpirt e xhan,
Se vjen erë sallam...

Ujku dhe kecat
(Në një kohë tjetër)

Ujku një ditë vere
U troket pas dere.
Këmba kësaj here
Lyer me gëlqere.
Zërin si boria:
- Jam unë, mama Dhia!

Kecat fort të zgjuar:
- S'është kohë e shkuar.
Thyej qafën, ik!
Kemi sy magjik…

Lojë

Tek luajnë me letra,
I thotë ujkut dhelpra:
- Je shah, je shah mat!

Dhe ujku s'ia zgjat:
- Ç'ia fut kot dhe kjo:
Jo shah, …domino!

Kopili

Pranë kazanit të një blloku
Veshët ngreh polic Maçoku,
Ndien kuisjet "Ham, ham, ham!"
Një këlysh me syçkat xham
Përpëlitej në kazan.

Shkund Maçoku ato qime:
- Dreq, kopil në zonën time!

Fët e fët jep shenjë me kokë.
Si rrufe nja dhjetë maçokë
Shtyjnë kazanin tejpërballë.

Pas një ore zhurmë e rrallë.
Polic Gici bëhet vrer,
I thotë shefit menjëherë:
- Ma kanë lënë kopil në derë…

Delet

Te kullota sheh thëllëza
Delebardha, delezeza.

Por në mbrëmje veç një ngjyrë:
Gjithë kopeja nxin qymyr...

Numri i këmbës

Dhelpra e gomari
Grepën për së mbari
Në supermarket.

Mbi motoçikletë
Çajnë suferinë.
Pas kanë policinë,
Gicin me makinë.

Dhelpra në timon
Veshon urdhëron:
Këmbën pak ta zgjatë,
Ta bëjë barrikadë,
Të mbulohet targa.

Veshos çurgë jarga:
- Moj dinake, ç'thua,
T'më marrë këmbën mua!...

Pickimi

Buzëmbrëmje. Mu në tren
Një mushkonjë pickoi një qen.

Lehu qeni, vajmedet…
Nuk qe lehje, por tërmet.
Si iriq, përpjetë qimet:
- Mirë që hipe pa biletë,
Por ia nis dhe nga pickimet!

Kontraceptiv

Një herë gicit i flet gjyshi:
- Ti s'e di si lind këlyshi!

Hidhet gici, bëhet xhind:
- Unë e di dhe ...si nuk lind!

Tranvestitët

Gici gicit fësh në vesh:
- Bëjmë një Shah këtu, në shesh?

Tjetri vithet tul e dhjamë:
- Jo, më mirë luajmë Damë...

Celular

Buzë liqenit, në batak
Një bretkosë "kuak, kuak!"
Papushuar ditë e natë.
Pu-pu ç'zhurmë e shamatë...

Celularin çel një midhje:
- Boll me zë, kalo me dridhje...

Gjirafat

Shiti thiun blegtor Tafa,
Porse bleu dy gjirafa.

Ndryshe krejt nga soj' i thiut:
Rrjepin bahçen e komshiut…

Polici

Një polic si stekë, i gjatë,
Teksa kthehej për në fshat
Sheh një ujk në pyll dhe fap
Pistoletën vrulltas kap…

Në çast ujku ia jep vrapit,
Duke llapur pas hesapit:
“Po, polico, s’ke faj ti!
Të lashë gjallë, kur qe bari…”

Patenta

Hyn te kursi për shofer
Dhe një derr, një goxha derr.
Eh, ky derri, gjë e trashë,
I bën lëmsh freksion e marsh.

Instruktor ish një bizon:
- Ti, o mik, s'vlen për timon!
Ti, jo, jo, s'je për patentë,
Se i shtype katër vetë…

Derri hazër llap si qyp:
- Pse, dhe sa duhet të shtyp?!

Cigare

Teksa rrinte në tryezë,
Një kangur cigaren ndez;
Fët paketën fsheh në xhep.

Hidhet struci: - More lumë,
Një cigare s' po më jep!
O kangur, s' ke një më shumë?

Flet kanguri flakë për flakë:
- Jo, o struc, kam një më pak…

Dystabani

Elefant, o mik e xhan,
I ke këmbët dystaban.

Elefanto, je me qar:
E hedh lumin, s'shkon ushtar…

Dhelpra

Mburret dhelpra: "Kam pesë vjet,
S'vjedh një pulë, as gjeldet…"

Ju do thoni, bëri kthesë,
S'hyn më natën në qymez?!

Di pse hesht porsi një murgë:
Ka pesë vjet atje, në burg…

Rakia

Sherr me cjapin prapë dhia:
- Hiqu, cjapo, nga rakia,
Se u bëre gaz i botës…
More ti, ç'i ndien gotës?

Cjapi llafin zgjat tërkuzë:
- Ka një javë, s'e vë në buzë…

Hidhet dhia: - Pu - pu, ç'tip!
Ka një javë, e pi me pipë…

Bluza

Gici bleu te dyqani
Bluzë ngjyrë jargavani.

Ç'paska gici, u nguc grusht?!
I rri bluza fare ngushtë.

Vrap te mjeku, çeli buzën:
- Më dhemb noçka, kur heq bluzën!...

Akulloret

Bleu konia në shitore
Dy kaushë me akullore,
Një për motrën, një për vete.
Porse udhës teksa vete,
Një kaush i ra përtokë.

Tundi motra bisht e kokë,
I tha kones: - Ç'u përlote?

- Më ra akullorja jote!...

Qeni

Një zonjushe në pazar
Me një qen sa një gomar
Gjelkokoshi seç i tha:
- Mbaje qenin, se na ha!

Kjo zonjusha çoi ton:
- Nuk ju ha, veç ju kafshon…

Banania

Shkeli macja një banane,
Ra sa gjatë – gjerë…
Fët kotelja kujis, qan
Porsi kurrëherë.

- S'u lëndova, hesht, mos qaj! –
Macja qorton xhanen.

Flet kotelja si në faj:
- Po qaj për bananen…

Shqisat

Eh, cigare, moj cigare,
Ç'na i çmende shqisat fare!

Të mbërthejnë porsi darë
Buzët nxirë, buzët tharë.

Nikotinën me sa mund
Thith e thith e gjora hundë.

Thith me hundë, thith me gojë.
Nikotina të na rrojë!

Moj cigare, s'ke të dytë:
Tymi perde mu te sytë!

Ç'ngeli tjetër, hiç mos qesh!
Po e shkund hirin në vesh…

Përralla

Gjer më dje përralla niste:
“Na ishte seç na ishte… ”.

Sot me rrena nis vërtet:
“Po më zgjodhët deputet…”.

Kolltuku

Te vagoni, në një tren
Iu lut kones gjyshi qen:
- Mund të çohesh nga kolltuku?

Konia bishtin pak ia nduku:
- Që të çohem?! Kurrësesi,
Se kam frikë mos ma zësh ti…

Gici

Gici tapë qe në shkollë.
Që ta themi hollë – hollë,
Nuk kish marrë kurrë pesë,
Nxinin dyshat në dëftesë.

Nxinin dyshat, por sivjet
Po merr nëntë, po merr dhjetë.
Mami dosa një gic ka,
Ia mbush çantën me parà.

Ndaj dhe gici s'njeh më dyshat:
I ndan lekët fët me zyshat…

Rënie

Ra maçoku nga ballkoni
Lart, te kat' i njëmbëdhjetë.
"Ndjesë pastë! " ju do thoni.
Jo, or, jo, është në jetë.

Është gjallë, ta pret mendja:
S'ra nga jashtë, ra nga brenda…

Dashuri

Mjekërcjapi zonjën dhi
E ka shpirt e xhan.
Ndaj e sheh shpesh me dylbi,
Ta ketë sa më pranë…

Përdhunimi

Mbret Luani këtë herë
Shfryn si i tërbuar.
“Luaneshën mu në ferrë
Ma kanë përdhunuar.
Përdhunuesin po e kapa,
Koqet do t’ia pres…”

Një miush ndjek demin prapa,
Pyllit mespërmes.

- Ç’ke që ikën si veriu?! -
Po e tall një lamë.

Gjegjet miu kocomiu:
- Dhe unë mashkull jam!...

Thënia më e fundit

Që prej shekujsh rron e thëna:
“Qengj’ i urtë pi dy nëna.”

Më e fundit fare fare:
“Ujku pi shefen gomare…”

Cepi

Daci rrumbull, tapë, karroqe
Kolovitej porsi koqe.

Nëpër dhëmbë i flet micës:
- Ku është cepi i rrugicës?

Mica fap i shkel një sy:
- Po ti je tamam aty!

Pijaniku ç'i hedh grepin:
- Ndaj dhe unë s'po gjej dot cepin…

Fotoja

Ja një foto krejt e rrallë:
Katër zhaba paskan dalë
Gojëkyçur në moçal…

Erë

Kangurushi merr e jep,
Plot me hudhra mbush një xhep.

Ç'i leh qeni: - Jo, s'ke faj!
Nëse humb, gjendesh kollaj…

Unaza

(Sipas Shilerit)

Kjo unaza ç'po lë nam:
- Shpall martesat, jam me famë!

Pa dëgjoni qen fakirin:
- Eh, ç'e do, bën dhe zinxhirin…

Vegla muzikore

Kjo zonjusha kanarinë
Ç'na kënaq me violinë.

Dhe fazani pendëar
Luan ëmbël në kitarë.

Kurse buçja ndjek zakonin,
Luan bukur …seksofonin.

Martesë

Dhia heshtjen theu:
- Cjapi më gënjeu,
Ndaj dhe e kam marrë.
Më tha: "Je me barrë…"

Sharje

Foli Eva shend e verë:
- O Adam, pa shaj një herë!

Dhe Adami sy më sy:
- Kë të shaj, veç të shaj ty…

Arka e Noes dhe Titaniku

Foli Arka:
- More mik,
Më mirë Arkë
Se Titanik…

Teshtitje

Gjeli ynë është sëmurë,
Paska rrufë, temperaturë.

Gjeli ynë po, për besë,
Pi ilaçe plot një thes.

Po teshtiu sot këndesi,
Do shërohet gjithë qymezi…

Stinë

- Vjeshta, – pyet Era, -
Pse s'po vjen, moj nënë?

- Fajin e ka Vera,
Mbase është shtatzënë!...

Parajsa

- Sa për mua është farsë, -
Thirri kaposh trimi: -
Qysh u shkoka në Parajsë
Me makinë varrimi!

Veshëdylli

Veshët majmunushi
S'i pastron një herë.
Bletës llafet prush
Ç'ia lë mu në derë:
"Zoti pra, e faltë
Zemërgjerin pyll:
Ju prodhoni mjaltë,
Ne, majmunët …dyllë".

Veshi

- More, veshi të na rrojë! -
Një kërriç seç thotë: -
Se të kish veç pakëz gojë,
Lëmsh do qe kjo botë!

Arma

I thonë njërit në doganë:
- Ke me vete ndonjë armë?

Tjetri llafet fët i bluan:
- Armë the?! Jo, jo, kam gruan…

Kurnaci

Mesa thonë, një dac
Te tregu njëherë,
Edhe pse kurnac,
Blen një poç me verë.

Bie te një gropë,
Këmba i shket huq.
Poçi copë – copë,
Trupi flakë i kuq.

Llap daci torollak:
“Do Zoti, është gjak!”

Lodhje

Djersiste milingona
Në punë, tej në arë.

Ankohej mizëzonja,
Ç'u lodh duke e parë...

Zhapiku

Një zhapik te një lëndinë
Pasi thithi kokainë,
Ç'ia merr këngës si debil:
- S'jam zhapik, por krokodil !...

Ringjallje

Gomari veshgjatë
Ka shpresë te ringjallja,
Andaj që me natë
Ç'ia nisi nga pallja:
"Gjithë kafshët ta dinë,
Në fundin e jetës,
Se unë pasurinë
Ia lë vetëm vetes…"

Nobel

Çmim për Paqen
Jep çdo vit,
Ndonëse shpike
…Dinamit!

Sport

Me kaike hyn në garë
Një ekip me shtatë shqiptarë.

Eh, shqiptarët, veç me hile;
Ngelen prapa plot një milje.

Si përherë ky variant:
Një rremon, gjashtë në komandë…

Vizitë

Vajti njëri te doktori:
“Ha si derr, dreqi e mori!

Qoftë mbrëmje, qoftë drekë
E bëj gjumin si sheleg.

Rroj në paqe, në idil;
E kam zërin si bilbil.

Sa për punë nuk të fal,
Tetë orë porsi kalë…”

Tjetri llafet fët i nderi:
“Shko te mjek veterineri…”

Lëndët djegëse

Klasa zien mes e anë,
Lëndë djegëse cilat janë?

Vrull shigjete flet kanguri:
- Dhe benzina, dhe vajguri.

Padurimthi hidhet keci:
- Edhe nafta, edhe speci…

E hëna

Një të shtunë në pulari
Thirri gjeli: "Ki, ki, ki!
Sot, moj pula, është e shtunë.
Por të hënën kemi punë,
Dua vezë pa hesap…"

Pikaloshja sqepin hap,
I qet llafet me çengel:
"Po sikur të bjerë e diel?!"

Syri

Vështron anembanë
Gjithë këtë botë,
Veshin fare pranë
Ja që s'e sheh dot!

Pema

Mbi degë, dreq o punë,
Puthen dy majmunë.

Poshtë, te një krua
Një çift burrë - grua.

Femra fësh i tha:
- Bëjmë si ata?

Burri si në jerm:
- Kush hipën në pemë!

Kryemajmuni

Nga majmunët qe i Pari,
“Puf” nga pema te mullari.

Te mullari lart, në majë;
Do të hajë a do ta hajë?!

Te mullari rrjepin bar
Kuaj, mushka dhe gomarë.

Eh, majmun, majmun, ç’të zuri:
Sosi bari, ngeli huri…

Krizë Presidenciale

I sfilitur një majmun,
I papunë tash tre vjet,
Brofi befas: - Gjeta punë!
Ka vend bosh për President…

Pazi

Teta Dhia shkon në treg
Për të blerë spinaq.
Do të bëjë një byrek,
Kecat t'i kënaqë.

Katundari: - Teta Dhi,
S'ka spinaq, por ka pazi.

Teta Dhia krejt e qetë:
- Pa problem, e ziej vetë…

PËRMBAJTJA

Faqe

1. Mbreti xhuxh 3
2. Duhanpirësit 4
3. Tërheqje 5
4. Kaçurrelat 6
5. Era 7
6. Avokatja 8
7. Pendë 9
8. Zgjidhe shokun më të mirë! 10
9. Televizori 11
10. Qyl 12
11. Freskim 13
12. Fodulli 14
13. Gjuhë 15
14. Çorap 16
15. Fakti 17
16. Mesnatë 18
17. Veza 19
18. Xhep xhepisti 20
19. Shkrim e këndim 21
20. Verë 22
21. Birra 23
22. Banja publike 24

Faqe

23. Në urban 25
24. Tetanozi 26
25. Plakushi 27
26. Qimekuqi 28
27. Syzet 29
28. Panair 30
29. Skara 31
30. Shkrepëse 32
31. Burg 33
32. Futboll 34
33. Not 35
34. Defekt 36
35. Kopje 37
36. Origjina 38
37. Noterja 39
38. Xhepat 40
39. Toka 41
40. Taksia 42
41. Urim 43
42. Mbytje 44
43. Librezë uji 45
44. Shtatzënë 46
45. Çadrat 47
46. Kopsat 48
47. Kokë 49
48. Në Pranverë 50
49. Ndalim kalimi! 51
50. Provimi 52
51. Dushi 53
52. Varfëri 54
53. Ujku dhe kecat 55
54. Lojë 56
55. Kopili 57
56. Delet 58
57. Numri i këmbës 59
58. Pickimi 60
59. Kontraceptiv 61
60. Tranvestitët 62

Faqe

61. Celular 63
62. Gjirafat 64
63. Polici 65
64. Patenta 66
65. Cigare 67
66. Dystabani 68
67. Dhelpra 69
68. Rakia 70
69. Bluza 71
70. Akulloret 72
71. Qeni 73
72. Banania 74
73. Shqisat 75
74. Përralla 76
75. Kolltuku 77
76. Gici 78
77. Rënie 79
78. Dashuri 80
79. Përdhunimi 81
80. Thënia më e fundit 82
81. Cepi 83
82. Fotoja 84
83. Erë 85
84. Unaza 86
85. Vegla muzikore 87
86. Martesë 88
87. Sharje 89
88. Arka e Noes dhe Titaniku 90
89. Teshtitje 91
90. Stinë 92
91. Parajsa 93
92. Veshëdylli 94
93. Veshi 95
94. Arma 96
95. Kurnaci 97
96. Lodhje 98
97. Zhapiku 99
98. Ringjallje 100

Faqe
99. Nobel 101
100. Sport 102
101. Vizitë 103
102. Lëndët djegëse 104
103. E hëna 105
104. Syri 106
105. Pema 107
106. Kryemajmuni 108
107. Krizë Presidenciale 109
108. Pazi 110

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Lamaj, Ferit
Mbreti xhuxh: fabula / Ferit Lamaj; Red.: Jonida Lamaj. Pikt.: Llazar Taçi Tiranë: Ilar, 2007.
116 f ; 20.5 cm.
Fabula shqiptare

ISBN 978-99956-611-8-2